

PLANI SOCIAL VENDOR
BASHKIA DURRES
2025-2028



Funded by
the European Union

Ky Plan Social Vendor është hartuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e saj është përgjegjësi vetëm e autorëve të tij dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian. Ky Plan Social Vendor publikohet nëpërmjet Asistencës Teknike “Mbështetjes së Bashkimit Evropian për Përfshirjen Sociale në Shqipëri” (EU4SI), të dhënë nga Bashkimi Evropian për Bashkinë e Durrës, zbatuar nga GOPA Eorldeide Consultants.

Shkurtime

AK	Aftësi të Kufizuara
AKPA	Agjencia Kombëtare për Punësim dhe Aftësim
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
OJF	Organizat Jo Qeveritare
PAK	Person me Aftësi të Kufizuara
NE	Ndihmë Ekonomike
PMF	Punonjësi për Mbrojtjen e Fëmijës
NJVRN	Njësia Vlerësimit dhe Referimit të Nevojave
PSV	Plani Social Vendor
SHSSH	Shërbimi Social Shtetëror
UMM	Urdhër i Menjëhershëm Mbrojtjeje
UM	Urdhër Mbrojtje

Contents

Hyrje (1–1.5 faqe)	4
II. Metodologjia për Hartimin e Planit.....	5
III. DIAGNOZA.....	6
1. Diagnoza për kategoritë në nevojë	7
2 Diagnoza e shërbimeve shoqërore	23
3. Diagnoza për Burimet Njerëzore në Shërbimet Sociale në Bashkinë Durrës	30
4. Përmbyllje e diagnozës së Planit Social Vendor në Bashkinë Durrës.....	38
5. Analiza SËOT	39
IV. Vizioni, Misioni , Prioritetet Strategjike dhe Objektivat(2–3 faqe)	40
V. Plani i Veprimit.....	42
VI. Finalizimi i Planit Social Vendor	76
VII. Monitorimi dhe Vlerësimi	83
VIII Shtojca	86
Shtojca 1: Tabela e Ofruesve të Shërbimeve Shoqërore dhe shërbimet e ofruara në Bashkinë Durrës Maj 2024.....	87
Shtojca 2 Kuadri legjislativ	88
Shtojca 3 Qendrat e shërbimeve sociale të Bashkisë Durrës.....	89
Shtojca 4 Persona burimorë dhe profesionistë lokale për mbrojtjen sociale në nivel bashkie dhe njësis administrative.....	91
IX ANEKSE	92
Aneksi 1 Të dhëna statistikore.....	92

I.Hyrje

Durrësi, qytet me histori të pasur dhe energji zhvillimi, është një nga bashkitë më të mëdha dhe më dinamike të Shqipërisë. I njohur si një qendër kyçe ekonomike, turistike dhe portuale, Durrësi është gjithashtu një territor me kontraste sociale dhe sfida të theksuara. Sipas Cens 2023, në territorin e Bashkisë jetojnë 153 614 banorë, me një shpërndarje të balancuar gjinore (49.6% meshkuj dhe 50.4% femra), të ndarë në 11 njësi administrative: 6 urbane dhe 5 rurale (Sukth, Manëz, Rrashbull, Ishëm dhe Katund i Ri). Kjo përbërje e larmishme kërkon politika të diferencuara për zhvillimin dhe mbrojtjen sociale.

Gjatë viteve të fundit, emigracioni, turizmi sezonal dhe urbanizimi i shpejtë kanë ndikuar ndjeshëm jetën sociale dhe ekonomike të komunitetit. Tërmeti i vitit 2019 dhe pandemia COVID-19 sollën sfida të mëdha për qytetarët dhe strukturat publike, duke e bërë edhe më urgjente ndërtimin e një sistemi të fortë dhe gjithëpërfshirës të shërbimeve sociale. Në përgjigje, Bashkia Durrës ka miratuar Udhërrëfyesin për situatat emergjente dhe ka përfshirë masa konkrete për zbatimin e tij brenda Planit Vendor Social 2025–2028.

Territori i Bashkisë pasqyron sfida të mëdha sociale, të vërtetuara edhe përmes të dhënave konkrete: 1,288 fëmijë të identifikuar në rrezik, 1,926 të moshuar në nevojë, 4,458 persona me aftësi të kufizuara që përfitojnë nga skemat e mbrojtjes sociale, 174 raste të raportuara të dhunës në familje, etj. Këtyre u shtohen varfëria, papunësia e të rinjve, përjashtimi social i personave me aftësi të kufizuara, izolimi i të moshuarve, diskriminimi i komuniteteve rom dhe egjiptian, përhapja e përdorimit të substancave narkotike dhe alkoolit, si dhe mungesa e mbështetjes për personat LGBTIQ+.

Për t'u përballur me këto sfida, Bashkia Durrës ka hartuar Planin Vendor Social 2025–2028 si një dokument udhërrëfyes që synon ndërhyrje të planifikuara, të matshme dhe të koordinuara për të përmirësuar jetën e qytetarëve dhe për të siguruar të drejta të barabarta për të gjithë. Ky plan është rezultat i një procesi pilot dhe inovator, ku Bashkia ka udhëhequr çdo fazë të përgatitjes: nga ngritja e strukturave drejtuese (Komiteti Drejtues dhe Grupi Teknik), te analizat e nevojave, prioritetet dhe konsultimet me komunitetin dhe aktorët lokalë – shkollat, qendrat shëndetësore, organizatat e shoqërisë civile dhe institucionet e rendit.

Plani mbështetet në parime të forta si barazia, gjithëpërfshirja, transparencia, decentralizimi dhe vendimmarrja e bazuar në fakte. Ai është hartuar në përputhje me kuadrin ligjor dhe strategjik shqiptar e ndërkombëtar, duke përfshirë Ligjin nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror”, Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Strategjinë Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2023–2030, strategjitë për PAK, barazinë gjinore, rininë, si dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe angazhimet për integrimin në Bashkimin Evropian.

Përmes këtij dokumenti, Bashkia Durrës jo vetëm që adreson nevojat emergjente sociale, por vendos themelet për një model të qëndrueshëm e gjithëpërfshirës në ofrimin e shërbimeve sociale – me qytetarin dhe komunitetin në qendër të veprimit.

II. Metodologjia për Hartimin e Planit

Hartimi i Planit Vendor Social të Bashkisë Durrës është zhvilluar në përputhje me udhëzimet metodologjike të përcaktuara në “Guidën për Hartimin e Planit Social Vendor në Shqipëri” (2025), duke ndjekur një qasje gjithëpërfshirëse, të bazuar në të dhëna dhe të orientuar drejt rezultateve. Procesi i hartimit të Planit Vendor Social është konceptuar për periudhën janar 2025 – qershor 2028, duke zgjatur 3.5 vjet në vend të ciklit standard trevjeçar. Kjo zgjedhje u bë për të mundësuar një zbatim më të plotë të masave prioritare dhe për të krijuar një periudhë tranzitore të mjaftueshme për lidhjen e këtij plani me ciklin e ardhshëm të planifikimit

Procesi është strukturuar në tre faza kryesore, duke ndjekur një qasje pjesëmarrëse, të bazuar në të dhëna dhe të orientuar drejt rezultateve konkrete:

Faza I: Mbledhja e të dhënave

Kjo fazë synoi grumbullimin e informacionit sasior dhe cilësor për të siguruar një kuptim të thelluar të nevojave sociale në territorin e Bashkisë Durrës. Aktivitetet përfshinë:

- ✓ Krijimi i Komitetit Drejtues dhe Grupit Teknik për të garantuar koordinimin institucional dhe përfaqësimin e aktorëve lokalë.
- ✓ Hartimi i hartës së aktorëve dhe ndërtimi i një baze të dhënash për personat burim dhe institucionet që ofrojnë shërbime sociale.
- ✓ 6 (gjashtë) Intervista me ofrues publikë dhe privatë të shërbimeve sociale, për të identifikuar boshllëqet ekzistuese dhe mundësitë për përmirësim.
- ✓ Mbledhja e dokumentacionit dhe të dhënave statistikore, nga institucionet lokale dhe qendrore, për të ndërtuar një bazë të qëndrueshme për analizën e situatës.
- ✓ 5 (pesë) takime me përfitues dhe jo-përfitues të shërbimeve sociale, për të siguruar një qasje gjithëpërfshirëse dhe për të reflektuar mbi përvojat konkrete të qytetarëve (aktivitet opsional).

Faza II: Vlerësimi dhe prioritarizimi i nevojave sociale

Kjo fazë përfshiu përpunimin dhe analizën e të dhënave të mbledhura, për të identifikuar çështjet kryesore sociale në bashki:

- ✓ U realizua një analizë e thelluar e të dhënave sasore dhe cilësore, përmes mjeteve vizuale dhe analizës SËOT për secilën kategori vulnerabël.
- ✓ U organizua seminari konsultativ me aktorët lokalë, sipas modelit “seminar kafe”, për të diskutuar dhe vlerësuar prioritetet sociale.
- ✓ U përgatit dhe u miratua raporti diagnostikues, me pjesëmarrjen e grupit teknik dhe miratimin e Komitetit Drejtues, duke identifikuar qartësisht çështjet prioritare në Durrës.
- ✓ Prioritetet janë përcaktuar duke marrë në konsideratë urgjencën, ndikimin dhe mundësitë reale për ndërhyrje.

- ✓ Të dhënat e përdorura në këtë fazë i përkasin periudhave janar–maj 2022 dhe janar–maj 2024. Për kategori si NE, PAK dhe viktimat e dhunës janë krahasuar të dhëna ndër vite, ndërsa për kategori të tjera, si të moshuarit, janë përdorur vetëm të dhënat e janar–maj 2024.

Faza III: Hartimi dhe finalizimi i Planit Social

Kjo fazë përmbledhi orientimet strategjike në një plan konkret veprimi:

- ✓ U ndërtuan fletëveprimet për çdo objektiv specifik dhe masë ndërhyrëse, të cilat përfshijnë qëllimin, aktivitetet, partnerët, burimet financiare dhe treguesit e monitorimit.
- ✓ U organizua një raund diskutimesh me Komitetin Drejtues për të përcaktuar planifikimin trevjeçar dhe burimet e mundshme financiare.
- ✓ U organizua takimi me donator dhe OJF për të prezantuar fletëveprimin dhe për të diskutuar mundësitë e bashkëpunimit në financimin e masave prioritare të planit.

Pas hartimit të Planit Social Vendor, ky i fundit prezantohet dhe miratohet nga Këshilli Bashkiak, Bashkia Durrës dhe me pas ndërtohet një process informimi për komunitetin.

Qasja metodologjike

- ✓ U ndoq një strukturë e thjeshtë dhe e kuptueshme, e testuar në 5 bashki të tjera në Shqipëri.
- ✓ Aktorët lokalë kanë qenë pjesë e pandarë e çdo hapi, duke siguruar përvetësim dhe legjitimitet.
- ✓ Janë përdorur instrumente praktike dhe standarde për mbledhjen, analizën dhe dokumentimin e të dhënave, sipas modeleve të përfshira në Guidë.

Në kuadër të këtij procesi janë angazhuar rreth 200 pjesmarrës (aktorë lokalë si drejtues dhe profesionistë të institucioneve lokale dhe rajonale, përfaqësues të shoqërisë civile, banorë të bashkise përfitues dhe jo përfitues të shërbimeve shoqërore), përmes intervistave, takimeve konsultative dhe përfshirjes si anëtarë të Komitetit Drejtues e Grupit Teknik.

Tabela nr1: Aktorët lokalë pjesmarrës në procesin e hartimit të Planit Social Vendor.

III. DIAGNOZA

Ky dokument përmbledh tre diagnoza kryesore të realizuara në kuadër të Planit Social Vendor të Bashkisë Durrës:

1. Diagnozën për kategoritë në nevojë,
2. Diagnozën për shërbimet shoqërore,
3. Diagnozën për infrastrukturën e ofrimit të shërbimeve dhe aksesit nga kategoritë në nevojë.

Secila diagnozë është ndërtuar mbi të dhëna statistikore, dokumente vendore dhe kombëtare, si dhe intervista e konsultime me aktorë lokalë. Analiza ndjek një strukturë të

unifikuar që evidenton sfidat aktuale, boshllëqet në sistem, kapacitetet ekzistuese dhe nevojat prioritare për ndërhyrje.

Dokumenti synon të ofrojë një pasqyrë të qartë për hartimin e objektivave dhe masave të ardhshme, duke kontribuar në forcimin e sistemit të mbrojtjes sociale dhe në garantimin e një mbështetjeje më të barabartë dhe gjithëpërfshirëse për të gjithë qytetarët në nevojë.

1. Diagnoza për kategoritë në nevojë

Hartimi i Planit Social Vendor të Bashkisë Durrës mbështetet në një diagnozë të detajuar të zhvillimeve demografike dhe sfidave sociale të territorit. Sipas Censurit 2023, në Bashkinë Durrës jetojnë 241,753 banorë, ndërsa të dhënat nga Regjistri i Gjendjes Civile për vitin 2024 raportojnë 341,425 banorë, me një rritje prej 4.6% krahasuar me vitin 2022. Ky hendek evidenton nevojën për unifikim të burimeve të të dhënave për planifikim të saktë. Ndërkohë, ndryshimet strukturore janë të dukshme: grupmosha 65+ është rritur me 9.3%, duke theksuar procesin e plakjes; lindshmëria ka rënë ndjeshëm; dhe migrimi i brendshëm ka intensifikuar zhvendosjen nga zonat rurale drejt qytetit. . Ndërmjet njësive administrative vërehen dallime të theksuara: popullsia në Manzë është rritur me 22.6%, ndërsa në Katund i Ri ka rënë me 11.8%, duke reflektuar zhvendosje të brendshme dhe dinamikë të ndryshme zhvillimi. Këto zhvillime ndikojnë ndjeshëm në kërkesat për shërbime dhe planifikimin e mbështetjes sociale në territor.

Në këtë kuadër, kapitulli trajton analizën e kategorive kryesore në nevojë në Bashkinë Durrës, duke vlerësuar numrin, shpërndarjen territoriale dhe sfidat e tyre specifike në funksion të hartimit të masave të përshtatura ndërhyrëse.

1.1 Diagnoza për familjet në nevojë

Diagnoza për familjet në nevojë në Bashkinë Durrës paraqet një vlerësim të integruar të faktorëve ekonomikë dhe socialë që ndikojnë në gjendjen e tyre, duke evidentuar sfidat, tendencat dhe nevojat prioritare për mbështetje të qëndrueshme.

Në aspektin ekonomik, familjet në nevojë janë familje pa të ardhura dhe me të ardhura të ulëta, të cilat përballen me vështirësi të vazhdueshme për të siguruar nevojat bazë të jetesës si ushqimi, strehimi, edukimi dhe shëndeti. Skema e ndihmës ekonomike vijon të jetë mekanizmi themelor i mbështetjes për familjet me të ardhura të ulëta ose pa të ardhura. Në maj 2024 përfitojnë ndihmë ekonomike 141 familje në nevojë (nga 135 familje përfituese në vitin 2022), me dominim të familjeve me 3–5 anëtarë, që përballen me kosto të larta jetese. Papunësia është një faktor që rëndon veçanërisht mbi këto familje: në 2024 janë regjistruar 6,137 persona të papunë, ku 65% janë të rinj në moshë pune (20-34 vjeç), shumica prej tyre anëtarë të familjeve vulnerabël, anëtarë të komunitetet rome/egjiptiane, gra kryefamiljare, persona me aftësi të kufizuara etj. Përfshirja shumë e ulët në formim profesional (vetëm 59 pjesëmarrës) pengon shkëputjen e familjeve në nevojë nga varësia ndaj ndihmës ekonomike. Në të njëjtën kohë, sigurimi i strehimit të qëndrueshëm përbën

një element kyç për forcimin e stabilitetit social të këtyre familjeve, për të cilat Bashkia ka ndërtuar mekanizma vlerësimi dhe prioritarizimi të kërkesave për strehim social, sidomos për familjet me ndihmë ekonomike, familjet e mëdha, personat me aftësi të kufizuara dhe viktimat e dhunës.

Në aspektin social, evidentohet një rritje graduale e kategorive në nevojë që përbëjnë komponentë të rëndësishëm të riskut familjar. Konkreisht numri i viktimave të dhunës është trefishuar (nga 15 raste në 2022 në 48 në 2024), rastet e jetimëve janë rritur nga 56 në 68, ndërsa numri i fëmijëve në kujdestari është pothuajse dyfishuar (nga 14 në 24 raste). Kjo tendencë pasqyron prezanton vëmendjen e shtuar të bashkisë në identifikimin, evidentimin dhe përfshirjen e këtyre familjeve në sistemin e mbështetjes sociale.

Shërbimet sociale ofrohen përmes 7 qendrave komunitare, përfshirë një qendër të lëvizshme, që mbulojnë rreth 996 familje, me fokus kryesisht njësitë administrative si Qyteti, Rrashbulli dhe Sukthi, ndërsa njësitë e tjera rurale kanë mbulim të fragmentuar dhe jo të qëndrueshëm. Megjithëse janë ndërmarrë hapa për zgjerimin e ndërhyrjeve përmes ngritjes së Njesisë së Vlerësimit dhe Referimit të Nevojave (NJVRN), angazhimit të administratorëve shoqërorë për ofrimin e shërbimeve parashoqërore dhe aktivizimit të shërbimit të lëvizshëm për situata emergjente, këto kapacitete aktuale nuk arrijnë të mbulojnë në mënyrë të plotë dhe të qëndrueshme nevojat e gjithë territorit. Kjo situatë evidencon nevojën për forcimin e rrjetit të shërbimeve sociale në nivel komunitar dhe zgjerimin e aksesit për kategoritë në nevojë, veçanërisht në zonat me mbulim të ulët aktual.

Fig 2 Ndërthurja e faktorëve të varfërisë dhe riskut social për familjet në nevojë (Burimi: Bashkia Durrës Maj 2024)




Fig 2 paraqet ndërthurjen e faktorëve kryesorë që ndikojnë në gjendjen e familjeve në nevojë në Bashkinë Durrës. Në bazë qëndrojnë mungesa e të ardhurave dhe papunësia, që prekin shumicën e familjeve, ndërsa shtimi i faktorëve si mungesa e formimit profesional, vështirësitë në strehim, problemet

shëndetësore e sociale dhe rastet e dhunës apo ato të fëmijëve jetimë, e bën situatën gjithnjë e më komplekse. Kjo ndërlidhje evidenton domosdoshmërinë e qasjeve të integruara dhe bashkëpunimit ndërinstitucional për menaxhimin efektiv të rasteve familjare.

Nevojat për ndërhyrje prioritare

- ✓ Zhvillimi i qasjeve të integruara ndërsektoriale për menaxhimin e rasteve komplekse familjare;
- ✓ Zgjerimi i shërbimeve komunitare në zonat rurale dhe periferike;
- ✓ Krijimi i skemave të ndërmjetësimit për punësim të asistuar për familjet në nevojë;
- ✓ Forcimi i programeve të trajnimit profesional për grupet më të ekspozuara ndaj papunësisë;

Familjet në nevojë mbeten boshti qendror i politikave sociale në Bashkinë Durrës. Menaxhimi efektiv i varfërisë shumëdimensionale dhe riskut kompleks kërkon forcim të mëtejshëm të kapaciteteve vendore, qasje të personalizuar multidisiplinare dhe bashkëpunim të vazhdueshëm ndërinstitutional për garantimin e integritetit të qëndrueshëm social dhe ekonomik të këtyre familjeve.

1.2 Diagnoza për Personat me AK


Personat me aftësi të kufizuara përfaqësojnë një nga grupet më të ndjeshme dhe prioritare për politikën sociale të Bashkisë Durrës. Kjo diagnozë paraqet një vlerësim të detajuar të situatës, duke evidentuar shpërndarjen demografike, llojet e kufizimeve, sfidat sociale dhe boshllëqet në ofrimin e shërbimeve, me qëllim orientimin e planeve të integruara të mbështetjes.

Shpërndarja demografike dhe llojet e kufizimeve

Në vitin 2024, Bashkia Durrës numëron gjithsej 4,458 persona me aftësi të kufizuara (PAK). Shpërndarja territoriale tregon përqendrim më të madh në qytet (3,008 persona), ndërsa njësitë si Rrashbull (4.76%) dhe Katundi i Ri (1.67%) kanë përqindje më të larta në raport me popullsinë lokale. Sipas llojit të kufizimit, 71.9% i përkasin kategorisë “persona me aftësi të kufizuara të tjerë”, 19.2% janë të verbër dhe 8.9% janë paratetraplegjikë. Kjo shpërndarje tregon diversitetin e nevojave që kërkojnë qasje të personalizuar në planifikimin e shërbimeve.

Fig 3. Shpërndarja e personave me aftësi të kufizuara sipas kategorive në Bashkinë Durrës, 2024 (Burimi: Bashkia Durrës Maj 2024)

Në fig.3, njësitë Rrashbull dhe Katundi i Ri kanë përqindjen më të lartë të PAK në raport me popullsinë përkatëse, me 4.76% dhe 1.67% respektivisht, ndërsa Qyteti Durrës ka numrin më të madh absolut të PAK, por përqindje më të ulët për shkak të popullsisë së lartë. Kjo shpërndarje thekson nevojën për planifikim më të drejtë të burimeve dhe



shërbimeve, duke marrë parasysh jo vetëm numrin absolut por edhe përqindjen e PAK në raport me popullsinë.

Shërbimet ekzistuese dhe mbulimi

Aktualisht, në territorin e Bashkisë Durrës funksionojnë 11 shërbime për PAK të organizuara në 7 qendra sociale ku marrin shërbime 280

persona, të fokusuara kryesisht tek fëmijët me AK (0–21 vjeç). Shërbimet ofrohen kryesisht në qytet dhe nga ofrues jopublikë ose me financim të përzier, duke nënvizuar varësinë nga donatorët dhe sfidat për qëndrueshmëri financiare. Mungojnë shërbime të dedikuara për të rriturit me AK dhe për personat me nevoja të kombinuara fizike dhe mendore. Infrastruktura e papërshtatur dhe kapacitetet e kufizuara të stafit e bëjnë sfidë edhe ofrimin e shërbimeve ekzistuese.

Përfitimi nga skemat mbështetëse

Nga totali i PAK, rreth 889 persona (28%) përfiton nga skema e ndihmës personal, me mbulim të mirë për personat paratetraplegjikë dhe mbulim më të ulët për grupet e tjera.

Situata në arsim dhe punësim

Në sistemin arsimor janë të përfshirë 329 PAK, kryesisht në arsimin 9-vjeçar. Mbështetja është e kufizuar në arsimin e mesëm për shkak të mungesës së mësuesve ndihmës, infrastrukturës së përshtatur dhe shërbimeve mbështetëse. Në fushën e punësimit, vetëm 206 PAK janë të regjistruar si punëkërkues, ndërsa mungojnë të dhëna për pjesëmarrjen në formim profesional, duke treguar boshllëqe serioze në lidhjen mes aftësisht dhe integritimit në tregun e punës.

Faktorët e rrezikut dhe ndërthurja ndërsektoriale

Situata e PAK lidhet ngushtë me sfida komplekse si: papunësia, përjashtimi arsimor, kufizimet shëndetësore, mungesa e përkujdesjes së specializuar dhe mbështetjes në familje. Varfërimi i familjeve për shkak të mungesës së punësimit dhe aftësisht shton varësinë ekonomike të PAK dhe familjarëve të tyre. Infrastruktura e papërshtatur kufizon përshirjen aktive në jetën komunitare. Kjo situatë kërkon ndërhyrje të integruara ndërsektoriale, ku arsimi, punësimi, mbrojtja sociale, shëndetësia dhe infrastruktura bashkëpunojnë për garantimin e jetesës së pavarur dhe dinjitoze.

Për të ilustruar mënyrën se si këta faktorë ndërthuren në përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara, në vijim paraqitet cikli ndërsektorial i përfshirjes së PAK.




Fig.4 Skema paraqet ndërvarësinë ndërsektoriale të shërbimeve që nevojiten për përfshirjen e plotë të personave me aftësi të kufizuara në Bashkinë Durrës. Integrimi social dhe ekonomik i PAK kërkon koordinim të vazhdueshëm mes fushave të arsimit, formimit profesional, punësimit, shëndetësisë, shërbimeve sociale, strehimit, mbështetjes psiko-sociale dhe infrastrukturës së përshtatshme. Vetëm përmes funksionimit të sinkronizuar të këtyre komponentëve mund të garantohet jetesë e pavarur dhe dinjitoze për personat me aftësi të kufizuara.

Nevojat për ndërhyrje prioritare:

- ✓ Zgjerimi i shërbimeve për të rriturit me aftësi të kufizuara dhe personat me nevoja të kombinuara.
- ✓ Shtrirja territoriale e shërbimeve në zonat rurale për akses të barabartë.
- ✓ Forcimi i kapaciteteve profesionale të stafit dhe strukturave publike.
- ✓ Sigurimi i qëndrueshmërisë financiare të shërbimeve përmes rritjes së financimit nga buxheti vendor dhe krijimit të bashkëpunimeve afatgjata me organizata jopublike, donatorë dhe sektorin privat.
- ✓ Nxitja e PAK drejt programeve për punësim të asistuar dhe formim profesional të dedikuar për PAK.
- ✓ Fushata të ndërgjegjësimit dhe informimit për aftësinë e kufizuar, drejtuar si komunitetit ashtu edhe vetë PAK.

Personat me aftësi të kufizuara përfaqësojnë një nga prioritetet strategjike të Bashkisë Durrës. Vitet e fundit janë realizuar hapa të rëndësishëm në ndërtimin e shërbimeve fillestare dhe në forcimin e njohjes institucionale të problematikave. Megjithatë, sfidat në kapacitete, mbulim territorial, integrim në arsim dhe treg pune, si dhe qëndrueshmëri financiare mbeten thelbësore. Bashkia ka potencialin të konsolidojë një sistem të koordinuar dhe të qëndrueshëm mbështetjeje, të bazuar në qasje të integruar dhe bashkëpunim ndërsektorial.

1.3 Diagnoza e fëmijëve në rrezik

Fëmijët përbëjnë një nga grupet më të ndjeshme dhe prioritare për mbrojtje sociale në Bashkinë Durrës. Sipas Cens 2023, fëmijët 0–18 vjeç përbëjnë 24.55% të popullsisë, përqindje më e lartë se mesatarja kombëtare, duke e theksuar rëndësinë e ndërtimit të një sistemi gjithëpërfshirës të mbështetjes./ duke e bërë domosdoshmëri forcimin e sistemeve gjithëpërfshirëse të mbrojtjes së fëmijëve dhe parandalimit të riskut social.


Situata e fëmijëve në rrezik

Gjatë vitit 2024 janë identifikuar 1,288 fëmijë në rrezik, të shpërndarë sipas kategorive:

- ✓ Fëmijë në familje me ndihmë ekonomike: 412 raste
- ✓ Fëmijë me aftësi të kufizuara fizike: 322 raste
- ✓ Fëmijë me aftësi të kufizuara mendore: 255 raste
- ✓ Fëmijë viktimë të dhunës, jetimë, jashtë sistemit arsimor, në situatë rruge, në konflikt me ligjin dhe të shfrytëzuar për punë: 299 raste

Situata reflekton një ndërlidhje të fortë të riskut me faktorët ekonomikë, socialë, arsimorë dhe familjarë. Përtej kategorive të evidentuara, ekzistojnë edhe grupe të tjera vulnerabël si: fëmijët e neglizhuar, viktimë të mungesës së prindërimit pozitiv, të abuzuar, viktimë të krimit kibernetik, bulizmit, ekstremizmit të dhunshëm, analfabetizmit, migrimit, kequshqyerjes, fëmijë të paregjistruar, të huaj rezidentë apo në transit, si dhe vajza të rrezikuara nga martesat e hershme dhe diskriminimi gjinor, etnik ose socio-ekonomik.

Fig 5. Fëmijët e evidentuar në rrezik sipas kategorive – Bashkia Durrës, 2024



Burimi: Bashkia Durrës Maj 2024

Fig 5 evidenton shpërndarjen e fëmijëve në rrezik sipas kategorive sociale, ku evidentohen kryesisht rastet që lidhen me vështirësi ekonomike, aftësi të kufizuara dhe faktorë socialë.

Shpërndarja territoriale e fëmijëve në rrezik

Të dhënat e mbledhura tregojnë një përqendrim më të lartë të rasteve në njësitë urbane dhe bregdetare (Durrës, Sukth, Rrashbull), ku ndikojnë edhe faktorë sezonalë (gjatë sezonit turistik shtohet numri i fëmijëve në situatë rruge). Në njësitë rurale (Manëz, Ishëm, Katundi i Ri), numri i rasteve është më i ulët për shkak të densitetit më të ulët të popullsisë, ndërsa mekanizmat e identifikimit dhe referimit të rasteve janë aktivë dhe funksionojnë në të gjitha njësitë.

Sistemi i koordinimit dhe funksionimi i mekanizmave të referimit

Bashkia Durrës ka ndërtuar dhe po e zbaton me sukses një sistem vendor të koordinuar për mbrojtjen e fëmijëve, i cili vepron përmes NJVRN, Grupit Teknik Ndërsektorial të Mbrojtjes së Fëmijëve dhe administratorëve socialë në njësitë administrative. Administratorët shoqërorë dhe NJVRN ofrojnë shërbime parashoqërore, kryejnë vlerësime të hershme të riskut, evidentojnë dhe raportojnë rastet, duke kontribuar aktivisht në parandalimin dhe menaxhimin e hershëm të rasteve në territor. Grupi Teknik Ndërsektorial zhvillon takime të rregullta mujore dhe sipas nevojës, duke garantuar koordinim efektiv në menaxhimin e rastet komplekse.

Situata në arsim

Në vitin 2024:

- ✓ 606 fëmijë ndjekin çerdhet (5 çerdhe publike).
- ✓ 3,400 fëmijë ndjekin kopshtet publike.
- ✓ Mbi 15,800 nxënës ndjekin arsimin 9-vjeçar publik; gjithsej 19,321 fëmijë në sistemin arsimor publik dhe privat.
- ✓ Arsimi i mesëm i përgjithshëm dhe profesional përshin 7,260 nxënës.

Megjithatë, mungojnë të dhëna të plota analitike për fëmijët që ndjekin formimin profesional apo arsimin në institucionet private.

Shërbimet shoqërore ekzistuese

Aktualisht, Bashkia Durrës ka zhvilluar një rrjet prej 7 qendrave sociale që ofrojnë shërbime të specializuara për fëmijët në rrezik, kryesisht në qytet, Sukth dhe Rrashbull. Paralelisht, përmes funksionimit aktiv të NJVRN, administratorëve shoqërorë dhe partnerëve të tjerë lokalë (si OJF etj), sigurohet evidentimi dhe mbështetja parashoqërore për fëmijët edhe në njësitë më periferike, duke mundësuar reagimin e hershëm dhe ndërhyrjen për parandalimin e rasteve. Nga 1,288 fëmijët e identifikuar, aktualisht 462 (rreth 36%) janë të përfshirë në programe konkrete mbështetëse, duke reflektuar potencialin për zgjerim të mëtejshëm të shërbimeve në të gjithë territorin.

Faktorët e rrezikut

Situata e fëmijëve lidhet ngushtë me:

- ✓ Varfërinë dhe papunësinë e prindërve.
- ✓ Dhunën në familje dhe konfliktet e familjare.
- ✓ Shërbime të pamjaftueshme ditore dhe mbështetëse në zonat ku mungojnë qendrat ditore për fëmijët;
- ✓ Nevojën për forcim të mëtijshëm të kapaciteteve profesionale për trajtimin e rasteve komplekse dhe për zgjerimin e mbulimit territorial të shërbimeve.

Nevoja për ndërhyrje prioritare

- Zgjerimi i shërbimeve komunitare në të gjitha njësitë administrative;
- Shtimi numerik dhe fuqizimi i burimeve njerëzore për menaxhimin e rasteve komplekse;
- Financimi i skuadrave mobile të terrenit për fëmijët në situatë rruge gjatë sezonit turistik;
- Thellimi i bashkëpunimit ndër-institucional mes arsimit, shëndetësisë, shërbimeve sociale dhe policisë;
- Sigurimi i qëndrueshmërisë financiare përmes rritjes së financimit vendor dhe ndërtimit të partneriteteve afatgjata me sektorin jopublik dhe privat;
- Shtimi i çerdheve, kopshteve dhe hapësirave të dedikuara për fëmijët, përfshirë këndet e lojërave në zonat urbane dhe rurale
- Hartimi i programeve parandaluese për edukimin prindër or dhe mbështetjen psiko-sociale.
- Fushata ndërgjegjësimi për të drejtat e fëmijëve dhe aksesin në mbrojtje sociale

Vlerësimi përfundimtar

Fëmijët në rrezik përbëjnë prioritetin më të lartë social për Bashkinë Durrës. Në vitet e fundit, bashkia ka ndërtuar dhe konsoliduar një nga sistemet më funksionale të referimit dhe koordinimit ndërsektorial në vend, duke garantuar identifikimin dhe menaxhimin efektiv të rasteve në kohë. Zhvillimi i shërbimeve mbështetëse dhe rritja e ndërgjegjësimin institucional kanë krijuar një bazë solide për mbrojtjen e fëmijëve. Në këtë kuadër, zgjerimi i mëtijshëm i shërbimeve në territor dhe forcimi i kapaciteteve profesionale do të thellojnë edhe më shumë funksionalitetin dhe gjithëpërfshirjen e sistemit vendor të mbrojtjes së fëmijëve.

1.4 Diagnoza e Personave të Moshuar në Nevojë

Personat e moshuar përfaqësojnë një grup gjithnjë e më prioritar për politikat sociale të Bashkisë Durrës, në kontekstin e plakjes së popullsisë, sfidave të reja sociale dhe nevojës për zhvillim të qëndrueshëm të shërbimeve sociale. Sipas Censs 2023, në Bashkinë Durrës jetojnë 29,781 persona mbi moshën 65 vjeç, që përbëjnë 14.8% të popullsisë, një përqindje afër mesatares kombëtare.

Gjendja aktuale e të moshuarve në nevojë

Të dhënat e vitit 2024 evidentojnë prezencë të konsiderueshme të të moshuarve që jetojnë në kushte vulnerabiliteti të lartë: të vetmuar, të varfër, me sëmundje kronike apo pa mbështetje familjare. Në total janë identifikuar 1,926 të moshuar në nevojë, përfshirë:

- 964 të vetmuar;
- 951 me sëmundje kronike;
- 1,383 që kanë nevojë për shërbime sociale.

Kategoria më e ekspozuar përfaqësohet nga të moshuarit që jetojnë të vetmuar, shpesh me probleme të shumëfishta shëndetësore dhe sociale.

Shpërndarja territoriale

Shpërndarja e të moshuarve në nevojë sipas njësive administrative tregon për ngarkesë më të lartë sociale në disa njësi administrative rurale. Në njësinë Manëz, 21.8% e personave të moshës mbi 65 vjeç janë identifikuar si të moshuar në nevojë; në Sukth kjo përqindje arrin në 20.9%, ndërsa në Rrashbull në 20%. Në këto zona rurale, numri i ulët i shërbimeve të strukturuar dhe largësia nga qendra urbane e shtojnë rrezikun e izolimit social dhe përjashtimit. Aktualisht, pjesa më e madhe e shërbimeve sociale për këtë grup ofrohen vetëm në zonën urbane të qytetit, ndërsa njësitë periferike përballen me mungesë të theksuar të qendrave ditore dhe shërbimeve mbështetëse në komunitet.

Sistemi ekzistues i identifikimit dhe koordinimit

Bashkia Durrës ka ndërtuar një sistem funksional të identifikimit dhe referimit përmes NJVRN-ve aktive në të gjitha njësitë administrative, administratorëve socialë që realizojnë vlerësime të hershme dhe referime, si dhe bashkëpunimit me organizatat jopublike për menaxhimin e rasteve komplekse. Megjithatë, mungon ende një platformë e qëndrueshme shërbimesh sociale të organizuara që të adresojë nevojat komplekse afatgjata.

Shërbimet ekzistuese

Aktualisht, për personat e moshuar ofrohen shërbime të kufizuara vetëm në qytet:

- Qendra Ditore për të Moshuar: 106 përfitues;
- Kryqi i Kuq: 40 përfitues;
- Qendra "Sot për të Ardhmen": 20 përfitues.

Në total, 166 të moshuar përfitojnë aktualisht shërbime të strukturuar sociale. Ky numër shënon një rritje krahasuar me vitin 2022 (145 përfitues). Nga këta përfitues, 42.8% janë gra.

Përtej zonës urbane, në njësinë Sukth ofrohet në mënyrë të kufizuar shërbim në familje për të moshuarit në nevojë, ndërsa në të gjitha njësitë administrative (përfshirë edhe Sukthin), të moshuarit në nevojë përfitojnë shërbime parashoqërore përmes asistimit dhe mbështetjes së administratorëve socialë dhe NJVRN-ve, të cilët kryejnë vlerësimin, referimin dhe monitorimin e rasteve.

Faktorët e rrezikut

- ✓ Vetmia dhe mungesa e mbështetjes familjare;
- ✓ Varfëria ekonomike dhe burimet e kufizuara financiare;
- ✓ Sëmundjet kronike dhe paaftësia fizike ose mendore;
- ✓ Mungesa e shërbimeve sociale të organizuara në komunitet (ditore, rezidenciale apo të kujdesit shtëpiak);
- ✓ Risku i izolimit social dhe marginalizimit, veçanërisht në zonat rurale.

Nevojat për ndërhyrje prioritare

- ✓ Zgjerimi i shërbimeve ditore komunitare për të moshuarit në njësitë me përqendrim më të larta të rasteve;
- ✓ Ofrimi i shërbimeve të kujdesit në familje për të moshuarit e vetmuar dhe me varësi të lartë funksionale;
- ✓ Krijimi i një qendre multifunksionale për të moshuarit me kapacitete të integruara;
- ✓ Forcimi i burimeve njerëzore dhe kapaciteteve profesionale për kujdesin social;
- ✓ Ndërtimi i shërbimeve alternative rezidenciale ose çlodhëse për raste komplekse;
- ✓ Përmirësimi i transportit, aksesit dhe komunikimit për të moshuarit në nevojë;
- ✓ Zhvillimi i programeve për aktivizimin social, pjesëmarrjen dhe vullnetarizmin;
- ✓ Fuqizimi i sistemit të integruar të informacionit për menaxhimin e rasteve dhe planifikimin e shërbimeve;
- ✓ Thellimi i partneriteteve me OJF-të dhe sektorin privat për ofrim shërbimesh afatgjata.

Vlerësimi përfundimtar

Personat e moshuar në nevojë përfaqësojnë një kategori në rritje që kërkon ndërtimin e një sistemi të decentralizuar, të aksesueshëm dhe të qëndrueshëm shërbimesh sociale të strukturuar, për të garantuar mbështetje dinjitoze dhe integrim aktiv të tyre në jetën komunitare. Pavarësisht përparësive aktuale për identifikim dhe referim të rasteve, mungesa e shërbimeve të specializuara mbetet sfida më e madhme që kërkon adresim prioritar në planifikimet e ardhshme sociale të Bashkisë Durrës.

1.5 Diagnoza për viktimat e dhunës dhe trafikimit

Dhuna në familje dhe dhuna me bazë gjinore përbëjnë një nga sfidat kryesore sociale në Bashkinë Durrës, duke ndikuar drejtpërdrejt mbi sigurinë, mirëqenien dhe të drejtat e grave, fëmijëve dhe grupeve vulnerabël. Këto fenomene janë të ndërlidhura me faktorë të shumëfishtë si varfëria, papunësia, përjashtimi social, mungesa e strehimit dhe barriera institucionale për akses në shërbime mbështetëse.

Në Bashkinë Durrës funksionon prej vitit 2011 Mekanizmi i Koordinuar i Referimit të Rasteve të Dhunës në Marrëdhëniet Familjare, i ngritur në zbatim të **Ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar**. Ky mekanizëm është ndër të parët e krijuar në nivel kombëtar dhe operon përmes **Komitetit Vendor të Referimit dhe Ekipit Teknik Vendor**, në bashkëpunim me institucionet publike përgjegjëse dhe organizatat jofitimprurëse që ofrojnë shërbime mbështetëse për viktimat e dhunës. Bashkia Durrës luan rol koordinues, duke siguruar ndërveprimin institucional për mbrojtjen dhe riintegrimin e viktimave.

Të dhënat e rasteve të dhunës për vitin 2024

Gjatë vitit 2024, në strukturat e koordinuara të bashkisë janë identifikuar 174 raste viktimash dhune, ndër të cilat:

- 163 viktima rezultojnë gjithashtu përfitues të ndihmës ekonomike, duke dëshmuar lidhjen e drejtpërdrejtë midis dhunës dhe përjashtimit socio-ekonomik;
- 90 Urdhra të Menjëhershëm të Mbrojtjes (UMM) janë lëshuar;
- 84 Urdhra Mbrojtjeje (UM) janë lëshuar gjatë së njëjtës periudhë.

Duhet theksuar se këto të dhëna i përkasin kryesisht periudhës janar-maj 2024 dhe nuk përfaqësojnë totalin vjetor për vitin 2024. Për një pasqyrë të plotë të situatës, kërkohet konsolidimi i të dhënave nga të gjitha burimet institucionale: Policia, Prokuroria, Gjykatat, Koordinatorit Vendor, Shërbimi Social dhe organizatat partnere.

Shërbimet ekzistuese mbështetëse për viktimat


Viktimat e dhunës përfitojnë aktualisht një paketë të gjerë shërbimesh të integruara në Bashkinë Durrës, të ofruara nga aktorë vendorë dhe organizata partnere:

- ✓ Shërbime këshillimi psikologjik dhe social;
- ✓ Asistencë ligjore;
- ✓ Strehim emergjent dhe mbrojtje të menjëhershme;
- ✓ Mbështetje ekonomike përmes ndihmës ekonomike dhe mbështetjes së drejtpërdrejtë financiare;
- ✓ Fuqizim ekonomik dhe programe punësimi për viktimat;
- ✓ Shërbime rehabilituese dhe edukative për autorët e dhunës.

Gjatë vitit 2024, gjithsej 642 viktima kanë përfituar shërbime mbështetëse të specializuara:

- Shoqata "Gender, Paqe dhe Siguri": 547 raste;
- Qendra "Sot për të Ardhmen": 88 raste;
- Qendra për Emergjencë: 7 raste.

Figura 6. Viktimat dhe viktimat potenciale të dhunës që kanë përfituar shërbime (Janar-Maj 2024)



Burimi: Bashkia Durrës Maj 2024

Figura 6 paraqet numrin e viktimave dhe viktimave potenciale që kanë përfituar shërbime mbështetëse nga aktorët kryesorë në Bashkinë Durrës gjatë 5-mujorit të parë të vitit 2024, duke evidentuar rolin e rëndësishëm të OJF-ve në ofrimin e shërbimeve psikosociale për këtë kategori në nevojë.

Bashkia Durrës ka në funksion dy Koordinatorë Vendorë për Mbrojtjen nga Dhuna dhe një Specialist për Barazinë Gjinore. Mekanizmi Vendor funksionon rregullisht dhe përdor platformën REVALB për regjistrimin elektronik të rasteve.

Sfidat dhe boshllëqet

- ✓ Mungesë e sistemit të unifikuar të të dhënave mes institucioneve;

- ✓ Burime të kufizuara për mbështetje të vazhdueshme ekonomike për viktimat;
- ✓ Kapacitete të pamjaftueshme për strehimin emergjent, sidomos pas përfundimit të projekteve të mbështetura nga donatorët;
- ✓ Mungesë e shërbimeve këshillimore të strukturuar për autorët e dhunës;
- ✓ Mungesë e analizës periodike të profileve të viktimave sipas grupmoshave, gjinisë dhe karakteristikave të veçanta.

Nevojat për ndërhyrje prioritare

- ✓ Ristrukturimi dhe buxhetimi i qendrës ekzistuese të emergjencës me fondet e bashkisë;
- ✓ Thellimi i programeve psikosociale rehabilituese për viktimat;
- ✓ Ofrimi i shërbimeve këshillimore dhe edukative për autorët e dhunës;
- ✓ Fuqizimi i kapaciteteve financiare për mbështetjen ekonomike të viktimave;
- ✓ Fuqizimi i programeve të fuqizimit ekonomik dhe aftësimit profesional për viktimat;
- ✓ Rritja e koordinimit ndërinstitutional dhe ndërtimi i një sistemi të përbashkët informacioni për menaxhimin e rasteve;
- ✓ Zhvillimi i fushatave sensibilizuese dhe edukative në komunitet për parandalimin e dhunës.

Vlerësimi përfundimtar

Bashkia Durrës ka ndërtuar një mekanizëm funksional dhe të konsoliduar për menaxhimin e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore. Megjithatë, sfidat strukturore që lidhen me kapacitetet financiare, mbulimin gjithëpërfshirës të shërbimeve dhe koordinimin efektiv ndërinstitutional mbeten prioritare për tu adresuar në funksion të një qasjeje gjithëpërfshirëse, të qëndrueshme dhe transformuese për mbrojtjen e viktimave dhe reduktimin e dhunës.

1.6 Diagnoza për komunitetin rom dhe egjiptian

Komuniteti rom dhe egjiptian në Bashkinë Durrës përbën një nga grupet më vulnerabël që përballlet me sfida të ndërlidhura në fusha të ndryshme të jetës sociale, ekonomike dhe arsimore. Pavarësisht përpjekjeve institucionale, ky komunitet vazhdon të përballlet me papunësi të lartë, nivel të ulët të arsimimit, kushte të pasigurta strehimi, përjashtim social dhe diskriminim të vazhdueshëm, duke prodhuar një cikël varfërie të trashëguar ndër breza.

Megjithëse janë mbledhur të dhëna administrative dhe statistike për disa fusha kyçe, mungesa e një sistemi të integruar informacioni dhe të dhënave të plota nuk lejon të


kuptohet në mënyrë të plotë shkalla reale e përfshirjes së komunitetit në shërbime dhe të gjitha nevojat e tij specifike

Të dhënat ekzistuese

Sipas analizës së të dhunave vitit 2024 rezulton se:

- a) Komuniteti rom dhe egjiptian përfaqëson 10% të punëkërkesve të papunë të regjistruar në Bashkinë Durrës, me gjithsej 618 persona të papunë.
- b) Në sistemin arsimor publik në Bashkinë Durrës janë përfshirë:
 - ✓ 4 fëmijë romë dhe egjiptianë në çerdhe (0.66% e totalit);
 - ✓ 3 fëmijë në kopshte (0.09%);
 - ✓ 740 nxënës në arsimin 9-vjeçar (4.67% e totalit të nxënësve);
 - ✓ 42 të rinj në arsimin e mesëm (0.26%);
 - ✓ 15 të rinj në arsimin profesional (0.09%).
- c) Përfitojnë mbështetje nga shërbimet shoqërore që ofrohen në territorin e bashkisë:
 - ✓ 210 individë të cilët frekuentojnë shërbimet në qendrat komunitare (Nishtulla, Ushten, Nehemia, Sot për të Ardhmen);

Figura 7: Pjesëmarrja në arsim dhe papunësia (2024)



Burimi: Bashkia Durrës Maj 2024

Figura 7 prezanton nivelin e ulët të përfshirjes arsimore dhe shkallën e lartë të papunësisë në komunitetin rom dhe egjiptian, duke theksuar nevojën për ndërhyrje në arsim dhe punësim për të thyer ciklin e varfërisë së vazhdueshme

Shërbimet ekzistuese

Bashkia Durrës në bashkëpunim me partnerë institucionalë dhe organizatat jopublike, ofron shërbime të integruara për komunitetin rom dhe egjiptian:

- ✓ Mbështetje në Cash nëpërmjet skemës së ndihmës ekonomike për familjet romë në nevojë
- ✓ Pagesa për shkak të aftësisë së kufizuar për anëtarë të komunitetit rom dhe egjiptian të cilët janë vlerësuar person me aftësi të kufizuar nga komisionet përkatëse të vlerësimit
- ✓ Bonus strehimi për familjet romë në nevojë;
- ✓ Programe për fuqizimin ekonomik dhe punësimin e grave të komunitetit;
- ✓ Programe për uljen e braktisjes shkollore dhe mbështetje për përfshirjen në arsim për fëmijët e komunitetit;
- ✓ Shërbime psikosociale dhe edukative në qendrat komunitare.

Faktorët e Rrezikut

- ✓ Papunësi e lartë dhe mungesë mundësish të qëndrueshme për punësim;
- ✓ Varfëri e vazhdueshme dhe burime ekonomike të kufizuara;
- ✓ Nivel i ulët i arsimimit dhe braktisje e hershme shkollore;
- ✓ Mungesë e kualifikimeve profesionale;
- ✓ Diskriminim i vazhdueshëm në tregun e punës dhe në aksesin në shërbime;
- ✓ Strehim i pasigurt dhe problematika me legalizimin e banesave;
- ✓ Përfshirje sociale dhe përfaqësim i dobët në proceset vendimmarrëse;
- ✓ Akses i kufizuar në shërbimet shëndetësore, veçanërisht ato parandaluese.

Nevojat për ndërhyrje prioritare

- ✓ Orientimi drejt programe të aftësimi profesional dhe ndërmjetësimi për punësim;
- ✓ Zgjerim i programeve arsimore – edukative për parandalimin e braktisjes shkollore;
- ✓ Programe për fuqizimin ekonomik të grave të komunitetit;
- ✓ Mbështetje për dokumentacionin civil dhe integrimin administrativ;
- ✓ Përfshirje aktive të komunitetit në proceset e konsultimit dhe vendimmarrjes vendore.
- ✓ Informim dhe ndërgjegjësim i përshtatur për komunitetin rom dhe egjiptian mbi të drejtat dhe shërbimet sociale

Vlerësimi përfundimtar

Komuniteti rom dhe egjiptian në Bashkinë Durrës mbetet një nga grupet më të ekspozuara ndaj rrezikut të përjashtimit social dhe ekonomik. Megjithatë ekzistojnë programe mbështetëse, sfidat e lidhura me punësimin, arsimimin, strehimin dhe diskriminimin kërkojnë ndërhyrje të integruara dhe të qëndrueshme për të siguruar mundësi të barabarta për anëtarët e këtij komuniteti dhe për të thyer ciklin e varfërisë së trashëguar.

1.7 Diagnoza për individë përdorues të alkoolit

Në Bashkinë Durrës mungojnë të dhëna të strukturuar për individët që përballen me varësi nga alkooli, çka vështirëson identifikimin dhe trajtimin efektiv të nevojave. Megjithatë, problematika konsiderohet e pranishme dhe kërkon vëmendje për identifikim dhe monitorim në bashkëpunim me shërbimet shëndetësore e sociale. Krijimi i NJVRN përfaqëson një hap pozitiv drejt identifikimit të hershëm dhe mbështetjes për individët dhe familjet e prekura.

Varësia nga alkooli shpesh ndërthuret me probleme si dhuna në familje, papunësia, shëndeti mendor dhe përjashtimi social. Mungesa e një rrjeti të koordinuar shërbimesh e shton rrezikun për përsëritje të varësisë, duke ndikuar negativisht te individi, familja dhe komuniteti. Përfshirja e kësaj kategorie në Planin Social Vendor tregon angazhimin e Bashkisë për një qasje ndërsektoriale, të orientuar drejt parandalimit dhe rehabilitimit të qëndrueshëm.

1.8 Diagnoza për individë përdorues të drogës

Në Bashkinë Durrës mungojnë të dhëna të detajuara dhe të sistemuara për përdoruesit e drogave, çka vështirëson ndërtimin e ndërhyrjeve efektive për parandalim, trajtim dhe riintegrim social. Megjithatë, pranimi i ekzistencës së problematikës mbetet hap i rëndësishëm për forcimin e sistemit të parandalimit dhe trajtimit në nivel komunitar. Kjo situatë ndikon jo vetëm individët, por edhe familjet e tyre, të cilat përballen me sfida të shumta psikologjike dhe sociale.

Përdorimi i drogave është shpesh i ndërlidhur me varfërinë, papunësinë, dhunën në familje dhe problemet e shëndetit mendor, ndërsa mungesa e një rrjeti të integruar shërbimesh e shton rrezikun e përjashtimit. Përfshirja e kësaj kategorie në Planin Social Vendor tregon angazhimin e Bashkisë për të ndërtuar një qasje gjithëpërfshirëse dhe ndërsektoriale, ndërsa funksionalizimi i NJVRN-së pritët të përmirësojë identifikimin dhe menaxhimin e rasteve në bashkëpunim me partnerët.

1.9 Diagnoza për individë LGBTIQ+

Në Bashkinë Durrës mungojnë të dhëna të strukturuar për individët LGBTIQ+, çka e vështirëson vlerësimin e plotë të nevojave dhe planifikimin e ndërhyrjeve të përshtatura. Megjithatë, pranimi i ekzistencës së sfidave të përjashtimit social, dhunës psikologjike dhe mungesës së përkrahjes mbetet hap i rëndësishëm për adresimin e problematikës dhe ndërtimin e mekanizmave mbështetës. Përjashtimi që përjetojnë individët LGBTIQ+ është shpesh i ndërthurur me faktorë të tjerë cenueshmërie, si varfëria, dhuna në familje apo mungesa e mbështetjes psikosociale, sidomos për të rinjtë.

Përfshirja e masave për këtë komunitet në Planin Social Vendor dëshmon angazhimin institucional për ndërtimin e një mjedisi të barabartë dhe gjithëpërfshirës, ndërsa funksionalizimi i Njesisë së Vlerësimit dhe Referimit të Rasteve pritët të përmirësojë identifikimin dhe referimin e rasteve në bashkëpunim me organizatat për të drejtat e LGBTIQ+.

Përmbledhje e diagnozës sociale së familjeve dhe individëve në nevojë

Diagnoza gjithëpërfshirëse e situatës sociale në Bashkinë Durrës ka nxjerrë në pah sfida të shumta për kategoritë në nevojë, përfshirë fëmijët në rrezik, PAK, të moshuarit, viktimat e dhunës, komunitetet rome dhe egjiptiane, personat LGBTIQ+, përdoruesit e substancave dhe familjet në nevojë. Pavarësisht progresit në ngritjen e qendrave sociale dhe funksionalizimin e mekanizmave si NJVRN, mbrojtja sociale mbetet e fragmentuar, e përqendruar kryesisht në zonën urbane dhe me qasje të kufizuara në njësitë rurale si, Sukth dhe Rrashbull.

Një gjetje kyçe është ndërthurja në analizë e faktorëve të përjashtimit (papunësia afatgjatë, varfëria, mungesa e aksesit në arsim dhe shërbime, izolimi social) që përkeqësojnë gjendjen e individëve dhe familjeve në nevojë. Ndikimi i këtyre faktorëve ndjehet sidomos te fëmijët, të moshuarit, PAK dhe komunitetet e marginalizuara. Kjo kërkon ndërtimin e një politike sociale me qasje të integruar, gjithëpërfshirëse dhe të orientuar nga territori.

Megjithatë, Bashkia Durrës ka hedhur hapa të rëndësishëm drejt përmirësimit të sistemit të mbrojtjes sociale, përmes ngritjes së shërbimeve shoqërore për kategori në nevojë, përdorimit të sistemit REVALB për menaxhimin e rasteve dhe përcaktimit të kategorive prioritare për mbështetje. Gjithashtu, është evidentuar nevoja për forcimin e mëtejshëm të koordinimit ndërinstitutional, si një element thelbësor për garantimin e një qasjeje të integruar dhe efektive.

Në këtë kuadër, nevojat prioritare për ndërhyrje përfshijnë:

- Zgjerimin e shërbimeve shoqërore në të gjitha njësitë administrative, me fokus të veçantë në zonat rurale;
- Ndërtimin e një qasjeje të integruar për identifikimin dhe menaxhimin e rasteve;
- Forcimin e mekanizmave të koordinimit dhe përfshirjen e komunitetit në planifikim dhe monitorim;
- Konsolidimin dhe standardizimin e të dhënave për të gjitha kategoritë në nevojë;
- Rritjen e kapaciteteve lokale dhe profesionalizimin e stafit social.
- Rritjen e aksesit dhe informimit të qytetarëve mbi shërbimet sociale dhe të drejtat e tyre, përmes kanaleve të qarta komunikimi dhe mekanizmave të ndërveprimit me komunitetin

Ky dokument shërben si pikënisje për hartimin e politikave sociale të orientuara nga nevojat konkrete të qytetarëve dhe për ndërtimin e një sistemi më të drejtë, gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm të mbrojtjes sociale në Bashkinë Durrës.

2 Diagnoza e shërbimeve shoqërore

Diagnoza e shërbimeve shoqërore në Bashkinë Durrës ofron një panoramë të kapaciteteve ekzistuese, shpërndarjes territoriale dhe boshllëqeve në ofrimin e shërbimeve për grupet vulnerabël. Ajo mbështetet në të dhëna administrative, analiza vizuale dhe konsultime me


aktorët lokalë, duke synuar të evidentojë sfidat strukturore dhe mundësitë për ndërtimin e një sistemi më gjithëpërfshirës, të orientuar drejt nevojave reale të komunitetit..

1. Shërbimet ekzistuese dhe shpërndarja territoriale

Në territorin e Bashkisë Durrës ofrohen gjithsej 60 shërbime shoqërore të kategorizuara sipas tipologjisë në shërbime parashoqërore, komunitare, ditore, të specializuara, online, emergjente, lëvizëse, rezidenciale dhe në familje. **Shërbimet parashoqërore** përfaqësojnë nivelin e parë të mbështetjes sociale dhe janë të pranishme në të gjitha njësitë administrative të Bashkisë Durrës, përmes punonjësve të NJVRN, administratorëve shoqërorë dhe në bashkëpunim me OJF-të. Ato ndihmojnë në identifikimin e rasteve dhe referimin drejt shërbimeve të specializuara. Ndër shërbimet shoqërore të strukturuar, më të përhapura janë ato **komunitare, ditore, të specializuara**, me nga 9 shërbime aktive secila në territor. Në të njëjtën linjë, edhe **shërbimet online**, të ofruara kryesisht nga organizatat jofitimprurëse, janë të aksesueshme në të gjithë territorin e bashkisë, duke lehtësuar qasjen në informim dhe orientim për shërbime sociale, ndihmë ekonomike, mbrojtje nga dhuna dhe forma të tjera mbështetjeje, veçanërisht në zonat që nuk mbulohen nga struktura fizike shërbimesh.

Për të kuptuar më qartë përbërjen e shërbimeve të ofruara, më poshtë paraqitet grafiku përmbledhës mbi llojet dhe shpërndarjen e tyre.

Figura.8 Numri dhe llojet e shërbimeve shoqërore të ofruara në territorin e Bashkisë Durrës



Burimi: Të dhënat e Bashkisë Durrës, 2024

Fig 8 pasqyron llojet e shërbimeve shoqërore të ofruara në Bashkinë Durrës, ku vihet re një mbizotërim i shërbimeve parashoqërore, si forma më e përhapur e mbështetjes. Ndërsa shërbimet parashoqërore dhe online ofrohen në të gjitha njësitë, pjesa më e madhe e shërbimeve ditore dhe të specializuara janë të përqendruara në zonën urbane. Ky

përqendrim tregon për një pabarazi në aksesin territorial ndaj shërbimeve të strukturuar, duke theksuar nevojën për decentralizim dhe zgjerim të shërbimeve në zonat periferike.

Shërbimet më të strukturuar, si ato ditore, komunitare dhe të specializuara, kanë rëndësi të veçantë për mbështetjen e kategorive në nevojë, duke ndikuar drejtpërdrejt në përfshirjen e tyre sociale.

Larmia e formave të shërbimeve të ofruara në territor është e lidhur ngushtë me profilin dhe rolin e ofruesve të tyre (publikë dhe jopublikë) të cilët analizohen në seksionin në vazhdim.


2.Ofruesit e shërbimeve: publikë dhe jopublikë

Në total janë 21 ofrues aktivë të shërbimeve sociale në Bashkinë Durrës nga të cilët:

- 6 të financuar nga buxheti i bashkisë;
- 11 nga organizata jopublike dhe donatorë ndërkombëtarë;
- 4 me bashkëfinancim publik-jopublik.

Ky konfigurim pasqyron një model bashkëpunimi ndërsektorial mes bashkisë dhe sektorit jopublik, i cili është thelbësor për mbulimin e nevojave të ndryshme në territor. Kjo ndarje dhe përfshirje e aktorëve të ndryshëm pasqyrohet më qartë në figurën e mëposhtme, e cila ilustron burimet e financimit për shërbimet sociale sipas kategorive të ofruesve.

Figura 9 Burimet e financimit për shërbimet shoqërore në Bashkinë Durrës



Burimi: Bashkia Durrës, të dhëna të raportuara 2024

Figura 9 prezanton se struktura e financimit të shërbimeve sociale në Bashkinë Durrës tregon një mbështetje të lartë nga sektori jopublik, ku OJF-të dhe donatorët kontribuojnë me rreth 52% të totalit. Mbështetja nga buxheti vendor zë 28% të financimit, ndërsa pjesa tjetër mbulohet përmes bashkëfinancimeve (20%). Edhe pse përqindja e burimeve publike mbetet më e ulët në krahasim me partnerët jopublikë, fakti që Bashkia Durrës financon me

burimet e veta rreth një të tretën e shërbimeve sociale përbën një tregues pozitiv të angazhimit të saj institucional për mbështetjen e grupeve në nevojë.

Megjithatë, angazhimi financiar i bashkisë nuk mjafton për të adresuar në mënyrë të barabartë nevojat territoriale, veçanërisht në raport me sfidat infrastrukturore që pengojnë zgjerimin e rrjetit të shërbimeve. Aktualisht, njësitë rurale si Ishmi, Manza dhe Katundi i Ri nuk disponojnë hapësira publike të përshtatshme për ndërtimin e qendrave sociale të reja, çka kufizon mundësinë për të shtrirë shërbimet në terriore me akses të ulët. Kjo situatë, e kombinuar me burimet ende të pamjaftueshme dhe mungesën e infrastrukturës bazë në disa njësi administrative, e bën të vështirë garantimin e një mbulimi të drejtë dhe gjithëpërfshirës në të gjithë territorin. Sipas intervistave me përfaqësues vendorë, në tri njësi ku mungojnë aktualisht shërbimet ditore dhe komunitare, nuk ekzistojnë ambiente publike të përshtatshme për funksionimin e tyre. Për këtë arsye, bashkia po orienton ndërhyrjet drejt formave alternative si shërbimet lëvizëse dhe ato në familje, të cilat janë më fleksibël, kërkojnë më pak investime infrastrukturore dhe mundësojnë qasje të drejtpërdrejtë për grupet vulnerabël në zonat më të izoluara

Për të pasur një panoramë më të qartë të shtrirjes aktuale të shërbimeve shoqërore në territorin e Bashkisë Durrës, në vijim paraqitet një përmbledhje sipas njësive administrative, ku evidentohen format ekzistuese të mbulimit dhe drejtimet kryesore të rekomanduara për zhvillimin e mëtejshëm të shërbimeve sociale në çdo njësi.


Fig10: Shtrirja e shërbimeve shoqërore dhe prioritetet për zgjerim sipas njësive administrative në Bashkinë Durrës

Njësia Administrative	Shërbime shoqërore të ofruara	Statusi i mbulimit	Sugjerim
Qyteti Durrës	Po	Pjesor	Zgjerim shërbimesh dhe ngritja e shërbimeve të reja
Sukth	Po	Pjesor	Zgjerimi i shërbimeve ekzistuese
Rrashbull	Po	Pjesor	Zgjerimi i shërbimeve ekzistuese
Ishmi	Po	Pjesor	1-Përdorim hapësirash publike (si shkolla etj) 2-Ngritja e shërbit lëvizës/familjar 3-Rritja e partneritetit me OJF lokale
Manza	Po	Pjesor	1-Përdorim hapësirash publike (si shkolla etj) 2-Ngritja e shërbit lëvizës/familjar 3-Rritja e partneritetit me OJF lokale
Katundi i Ri	Po	Pjesor	1-Përdorim hapësirash publike (si shkolla etj) 2-Ngritja e shërbit lëvizës/familjar 3-Rritja e partneritetit me OJF lokale

3. Boshllëqet

Ky sesion synon të analizojë shpërndarjen dhe mbulimin aktual të shërbimeve shoqërore në territorin e Bashkisë Durrës, duke u bazuar në të dhënat për periudhën Janar-Maj 2024. Vëmendje e veçantë i kushtohet identifikimit të boshllëqeve në mbulim, qasjes territoriale dhe përfshirjes së kategorive në nevojë. Përmes krahasimit të statistikave, shpërndarjes gjeografike dhe analizës së të dhënave sipas kategorive përfituese, ky sesion synon të nxjerrë në pah pabarazitë ekzistuese dhe nevojën për ndërhyrje të strukturuar, veçanërisht në drejtim të decentralizimit dhe ndërtimit të databazave funksionale vendore.

Figura 11: Përqindja e përfituesve nga shërbimet sociale sipas kategorive në nevojë dhe grupet e pambuluara (2024)




Burime: Bashkia Durrës të dhëna Maj 2024

Analiza e të dhënave mbi përfituesit e shërbimeve shoqërore në Bashkinë Durrës evidenton pabarazi në mbulim dhe boshllëqe në ofrim. Në vitin 2024, përfituesit më të shumtë ishin familjet në nevojë, viktimat e dhunës, fëmijët dhe të rinjtë. Në të kundërt, mbulimi për komunitetin rom dhe egjiptian, të moshuarit dhe fëmijët me aftësi të kufizuara mbetet i ulët, duke sinjalizuar boshllëqe për kategori të caktuara. PAK-të e rritur, përdoruesit e substancave dhe individët LGBTIQ+ nuk mbulohen nga asnjë shërbim ekzistues.

Siç evidentohet në analizën territoriale më sipër, boshllëqet janë më të theksuara në zonat rurale, veçanërisht në Ishëm, Manzë dhe Katundi i Ri.

Më poshtë paraqitet shpërndarja e shërbimeve shoqërore sipas llojit në njësitë administrative të Bashkisë Durrës. Secili rreth me ngjyrë përfaqëson praninë e një shërbimi të caktuar në njësinë përkatëse.

Figura 12. Harta e mbulimit aktual të shërbimeve shoqërore për çdo njësi administrative në Bashkinë Durrës



Burimi: Bashkia Durrës Maj 2024

Figura evidenton përqendrimin e shërbimeve më të strukturuar në qytet dhe Sukth, ndërsa njësitë e tjera përfitojnë kryesisht nga shërbimet parashoqërore dhe online. Kjo tregon nevojën për zgjerimin e mbulimit të shërbimeve të specializuara dhe emergjente në zonat periferike

Në aspektin gjeografik, 17 nga 21 ofrues të shërbimeve janë të përqendruar vetëm në qytetin e Durrësit, ndërsa vetëm 4 operojnë në të gjitha njësitë administrative, me fokus më të lartë në Sukth dhe Rrashbull. Kjo shpërndarje reflekton pabarazi të qasjes dhe thekson nevojën për decentralizim dhe zhvillim të rrjetit të shërbimeve në zonat më të izoluara.

Tabela e mëposhtme përmbledh diagnozën e detajuar për secilën nga kategoritë në nevojë në Bashkinë Durrës, duke evidentuar shërbimet ekzistuese, problematikat dhe prioritetet për ndërhyrje, në funksion të garantimit të një mbulimi të barabartë dhe gjithëpërfshirës.

Figura 13

Kategoria	Sherbime te ofruara	Ofrues Shërbimesh	Problematika të evidentuara	Sugjerime për ndërhyrje
Familje në nevojë	Sherbime: 1- Parashoqerore; 2- ditore, 3-komunitare, 4-Te specializuara, 5- sherbim levizese	NJVRN dhe administratorët shoqërore; Qendra Fuqizojme Komunitetin; World Vision Durres; Qendra per Zhvillim Komunitar "Sot per te Ardhmen"; Qendra Komunitare Multifunkionale Rrashbull; Qendra per Sherbime Mbrojtese, Fuqizuese dhe Emergjente per Femijet dhe Familjen; Fondacioni "Ndihmë për fëmijët", Qendra Komunitare për Shërbime Sociale të Integruara për Familjen;	1-Mungesë databaze gjithëpërfshirëse per nevojat per sherbime; 2 -mungesa e sherbimeve ne 2 njesi administrative	Ndertimi I databazes per familjet ne nevoje, ngritja e sherbimeve per familjen ne 2 njesite qe nuk kane sherbime shoqerore
Fëmijë në nevojë	Sherbime: 1- Parashoqerore; 2- ditore, 3-komunitare, 4-rezidenciale, 5-Te specializuara, 6-Ne familje, 7-online, 8- emegjece	NJVRN dhe administratorët shoqërore; Qendra Fuqizojme Komunitetin; Qendra Komunitare Multifunkionale Nishtulla; World Vision Durres; Qendra per Zhvillim Komunitar "Sot per te Ardhmen"; Qendra Komunitare Multifunkionale Rrashbull; Fondacioni "Ndihmë për fëmijët", Qendra Komunitare për Shërbime Sociale të Integruara për Familjen ; Shtëpia e Foshnjës Durrës; Fondacioni Qendra kristiane e Durrësit; Shtëpia Orthodhokse e Shpresës; Qendra e Zhvillimit të Shoqerise Civile Durres .	1-Mungesë databaze gjithëpërfshirëse per nevojat per sherbime 2-mungojne sherbimet per femije ne 3 njesi administrative	Ndërtim i databazës së fëmijëve në nevojë Ngritja e qendrave komunitare ne 3 njesite administrative IShem, Manez, Katundi RI
Fëmijë me aftësi të kufizuara	Sherbime: 1- Parashoqerore; 2- ditore, 3-komunitare, 4-rezidenciale, 5-Te specializuara, 6-Ne familje, 7-online, 8- emegjece	NJVRN dhe administratorët shoqërore; Qendra Fuqizojme Komunitetin; Qendra per Zhvillim Komunitar "Sot per te Ardhmen" ; Qendra Komunitare Multifunkionale per femije me AK ; Qendra e Zhvillimit Rezidencial Durrës; Qendra e Shendetit Mendor "Drejt Zvillimit; Qendra TISS; Qendra e zhvillimit psikosocial Sol.	Mbulimi pjesor I nevojave per sherbime për fëmijët me AK si ne qyetet edhe në zonat rurale	Zgjerim i shërbimeve ditore dhe në familje per fëmijet me AK
Të rinj në rrezik	Sherbime: 1- Parashoqerore; 2- ditore, 3-komunitare, 4-rezidenciale, 5-Te specializuara, 6-Ne familje, 7-online, 8- emegjece	NJVRN dhe administratorët shoqërore;Qendra Fuqizojme Komunitetin;World Vision Durres; Qendra Komunitare Multifunkionale Nishtulla; Qendra per Zhvillim Komunitar "Sot per te Ardhmen"; Fondacioni "Ndihmë për fëmijët", Qendra Komunitare për Shërbime Sociale të Integruara për Familjen; Qendra e Zhvillimit të Shoqerise Civile Durres	Mbulim pjesor I nevojave per sherbime per te rinjte për të rinjtë (fëmijet ne konflikt me ligjin etj)	Ndertimi I partneriteteve me aktoret lokale ne mbeshtetje te te rinjve per orientim karriere, formim profesional, sherbime psiko-sociale per te mitur ne konflikt me ligjin
Të moshuar të vetmuar ose në varfëri	Sherbime: 1- Parashoqerore; 2- ditore, 3- ditore, 4-Te specializuara,	NJVRN dhe administratorët shoqërore; Qendra Fuqizojmë Komunitetin, Qendra Ditore për të Moshuar, Qendra për Zhvillim Komunitar "Sot per te Ardhmen", Kryqi i Kuq	Mbulim pjesor I nevojave per sherbime ne qendrat ekzistuese, Mungesë databaze për vetminë dhe varësinë	Identifikim proaktiv , ndertimi I data bases per te moshuar ne nevoje dhe nevojat e tyre, mbështetje sociale në shtëpi, zgjerimi I sherbimeve aktuale, ngritja e nje sherbimi te ri
Persona me aftësi të kufizuara (të rritur)	Nuk ka sherbime		Kosto e larte sherbimi ne ofrimin e sherbimeve per kete kategori	Hartimi i profilin social dhe ndertimi I shërbimeve pilote mbështetëse ne qendrat aktuale
Viktima të dhunës në familje	Sherbime: 1- Parashoqerore; 2- ditore, 3-komunitare, 4-rezidenciale/strehim, 5-Te specializuara, 6-online, 7- emegjece	NJVRN dhe administratorët shoqërore; Qendra Fuqizojme Komunitetin; Qendra per Zhvillim Komunitar "Sot per te Ardhmen"; Qendra per Sherbime Mbrojtese, Fuqizuese dhe Emergjente per Femijet dhe Familjen; Shoqata Gender, Paqe dhe Siguri	Kapacitet i kufizuar i structures ekzistuese dhe kufizim I sherbimit vetem per nenat me femije viktimat te dhunes	Rritje e kapaciteteve të structures ekzistuese dhe zgjerimi I spektrit te sherbimit per kategori te tjera viktimat te dhunes
Viktima të trafikimit	Ka sherbime por aktualisht nuk ka asnje rast qe perfiton		Burime te kufizuara financiare	Permiresimi I mekanizmit te referimit
Komuniteti rom dhe egjiptian	Sherbime: 1- Parashoqerore; 2- ditore, 3-komunitare, 4-Ne familje,	NJVRN dhe administratorët shoqërore; Qendra Komunitare Multifunkionale Nishtulla; Qendra Fuqizojme Komunitetin; Organizata Ushten; Qendra ditore Nehemia.	Mungesa e te dhenave te sakta te regjistrimit te civil per kete kategori. Mungesa e vetedeklarimit , Sherbime te fokusuar vetem ne kete komunitet Ndjekje e ulet e arsimit te mesem dhe profesional	Ngritja e sherbimeve te integruara per mbulimin e nevojave te komunitetit
Përdorues të substancave (droge dhe	Nuk ka sherbime		Mungese te dhenash dhe sherbimesh per personat dhe familjen	Fushata sensibilizuese dhe ndërtim protokollesh ne mbeshtetje te familjes
Individë LGBTIQ+	Nuk ka sherbime		Mungese te dhenash dhe sherbimesh per personat dhe familjen	Fushata sensibilizuese dhe ndërtim protokollesh ne mbeshtetje te familjes

Në përfundim, analiza tregon qartë se boshllëqet ekzistuese në mbulim dhe shpërndarje territoriale kërkojnë ndërhyrje të synuara, duke përfshirë forcimin e kapaciteteve lokale, rritjen e partneriteteve dhe aplikimin e modeleve fleksibël të shërbimeve për të garantuar akses të barabartë për të gjitha kategoritë në nevojë.

4. Nevojat prioritare për ndërhyrje në shërbimet sociale

- ✓ Zgjerimi i shërbimeve të strukturuar (ditore, komunitare, të specializuara) përtej zonës urbane, për të garantuar mbulim më të barabartë në të gjitha njësitë administrative.
- ✓ Zhvillimi i formateve fleksibël të shërbimeve, si shërbime lëvizëse, në familje dhe online, për zonat me akses të kufizuar si Ishmi, Manza dhe Katundi i Ri.
- ✓ Identifikimi dhe përshtatja e hapësirave publike ekzistuese (p.sh., shkolla, qendra komunitare) në njësitë rurale për përdorim social.
- ✓ Ndërtimi i databazave vendore funksionale për përfituesit dhe nevojat specifike sipas kategorive dhe njësive administrative.
- ✓ Rritja e angazhimit të Bashkisë në financimin dhe planifikimin strategjik të shërbimeve, me synim garantimin e qëndrueshmërisë përtej donatorëve.
- ✓ Thellimi i bashkëpunimit me Donatorë/OJF-të dhe partnerët lokalë për të shfrytëzuar kapacitetet e tyre në ofrimin dhe zgjerimin e shërbimeve.
- ✓ Zhvillimi i pikave të reja të referimit dhe këshillimit në komunitet, sidomos për kategoritë që nuk mbulohen aktualisht (PAK të rritur, LGBTIQ+, përdorues të substancave).
- ✓ Riorganizimi i rrjetit ekzistues të shërbimeve, për të shmangur mbivendosjen në qendër dhe për të siguruar përfshirje më të gjerë në periferitë e bashkisë.
- ✓ Forcimi i kapaciteteve të NJVRN dhe stafit vendor në nivelin lokal për të garantuar identifikim, referim dhe ndjekje efektive të rasteve në nevojë.

Përmbledhje e diagnozës sociale së shërbimeve shoqërore

Diagnoza e shërbimeve shoqërore në Bashkinë Durrës ofron një pasqyrë të qartë të kapaciteteve ekzistuese dhe të hapësirave për përmirësim. Ajo tregon se, megjithëse pjesa më e madhe e shërbimeve të strukturuar janë të përqendruara në zonën urbane, ekziston një bazë funksionale mbi të cilën mund të ndërtohet një rrjet më i gjerë, më gjithëpërfshirës dhe më i aksesueshëm për të gjitha njësitë dhe kategoritë në nevojë. Angazhimi i aktorëve vendorë dhe bashkëpunimi me organizatat partnere krijon mundësi reale për zhvillim të mëtejshëm. Duke investuar në decentralizim, rritjen e kapaciteteve vendore dhe zgjerimin e formave të ofrimit të shërbimeve, Bashkia Durrës ka potencialin të ndërtojë një sistem mbështetjeje social të qëndrueshëm, efikas dhe të ndjeshëm ndaj nevojave të komunitetit.

3. Diagnoza për Burimet Njerëzore në Shërbimet Sociale në Bashkinë Durrës

Shërbimet sociale në Bashkinë Durrës janë të organizuara në kuadër të Drejtorisë së Shërbimeve Sociale (Drejtoria), e cila përfshin tre sektorë funksionalë: Sektorin e Ndhmës Ekonomike dhe Paaftësisë, Sektorin e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale, dhe Sektorin e Planifikimit Strategjik dhe Monitorimit, si dhe NJVRN, e ngritur pranë bashkisë sipas parashikimeve të Ligjit nr. 121/2016.

Drejtoria mbulon një gamë të gjerë funksionesh dhe shërbimesh, që nga administrimi i skemave të mbështetjes financiare deri te ofrimi i shërbimeve komunitare për grupet vulnerabël.

- **Pagesa cash**, përfshirë ndihmën ekonomike për familjet dhe individët në nevojë, pagesat për personat me aftësi të kufizuara, invalidët e punës, Jetimët, viktimat e dhunës dhe trafikimit, kujdestarinë alternative etj.
- **Shërbime shoqërore të strukturuar dhe të specializuara**, të ofruara përmes qendrave sociale nën varësinë e bashkisë, për kategori si fëmijët dhe familjet e tyre në nevojë, fëmijët me aftësi të kufizuar, të moshuarit, viktimat e dhunës me bazë gjinore apo në marrëdhëniet familjare.
- **Shërbime të vlerësimit dhe referimit të rasteve**, të ofruara nga NJVRN, që synojnë adresimin individual të nevojave të qytetarëve dhe lidhjen e tyre me shërbimet përkatëse.

Ajo është përgjegjëse gjithashtu për identifikimin e nevojave në territor, hartimin dhe buxhetimin e Planit Social Vendor, planifikimin e paketës bazë të shërbimeve, ndjekjen e standardeve dhe treguesve të performancës, si dhe mbikëqyrjen dhe monitorimin e cilësisë së shërbimeve shoqërore në nivel vendor.


Pavarësisht përpjekjeve për funksionalizimin e një strukture të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, sfidat mbeten të shumta. Disa nga më të theksuarat janë:

- ✓ Shpërndarja e pabarabartë e stafit në njësitë administrative dhe në territor, me përqendrim të lartë në qytet dhe mungesë prezence në zona rurale;
- ✓ **Në strukturë mungojnë pozicione të dedikuara për kategori specifike në nevojë**, si të moshuarit, përdoruesit e substancave etj, ndërkohë që janë të emëruar vetëm specialistët e përcaktuar si detyrim ligjor (PMF, Koordinatorit për Dhunën dhe NJVRN).;
- ✓ Mbingarkesa e vazhdueshme e stafit, për shkak të numrit të kufizuar të punonjësve në raport me nevojat e komunitetit;

Nga ana tjetër, bashkëpunimi shumë i mirë që Bashkia Durrës ka ndërtuar me OJF-të, sektorin privat dhe aktorë të tjerë lokalë përbën një pikë të fortë, e cila ndihmon në zhvillimin dhe diversifikimin e shërbimeve të integruara

Aktualisht, në territorin e bashkisë funksionojnë shtatë qendra të shërbimit ditor dhe komunitar, të menaxhuara nga Bashkia, ndërsa një sërë shërbimesh të tjera vazhdojnë të ofrohen vetëm nga organizatat jo-qeveritare.

Grafiku 14 Struktura organizative e Drejtorisë së Shërbimeve Sociale në Bashkinë Durrës



Grafiku paraqet organizimin funksional të Drejtorisë së Shërbimeve Sociale në Bashkinë Durrës, përfshirë tre sektorët kryesorë dhe NJVRN, si dhe qendrat që ofrojnë shërbime të drejtpërdrejta për qytetarët. Struktura pasqyron përpjekjet e bashkisë për të ndërtuar një rrjet të koordinuar dhe të integruar shërbimesh sociale në nivel vendor.

Këto sfida strukturore dhe funksionale evidentojnë nevojën për ndërhyrje të menjëhershme në forcimin e kapaciteteve njerëzore, me qëllim garantimin e shërbimeve të aksesueshme, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme në të gjithë territorin e bashkisë.

2. Të dhënat ekzistuese dhe boshllëqet

Analiza e të dhënave ekzistuese dhe boshllëqeve në ofrimin e shërbimeve sociale nga Bashkia Durrës synon të japë një panoramë të qartë mbi kapacitetet strukturore, funksionale dhe territoriale të sistemit aktual të mbrojtjes sociale. Ajo shqyrton përbërjen dhe organizimin e burimeve njerëzore, funksionimin e njësive të specializuara dhe shërbimet që ofrohen përmes qendrave sociale. Gjithashtu, theksohen format e bashkëpunimit ndër-institucional dhe partneritetet me OJF-të, si dhe ndërhyrjet në fushën e

emergjencave sociale, duke evidentuar boshllëqet që ndikojnë në cilësinë, përhapjen dhe gjithëpërfshirjen e shërbimeve.

Struktura e burimeve njerëzore për ofrimin e shërbimeve sociale në Bashkinë Durrës përfshin tre sektorë dhe njësi të dedikuara brenda Drejtorisë së Shërbimeve Sociale.

Sektori i Shërbimeve Sociale

Sektori i Shërbimeve Sociale luan rol qendror në zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen dhe përfshirjen sociale, duke përfshirë pozicionet e detyrueshme ligjore si Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijës (PMF), Koordinatorin Vendor për Dhunën në Familje, si dhe specialistët për grupet në nevojë. Këta specialistë ofrojnë mbështetje për individët dhe familjet që përballen me vështirësi të theksuara sociale dhe ekonomike. Ky sektor bashkëpunon në mënyrë të rregullt me administratorët shoqërorë në njësitë administrative, duke mundësuar identifikimin e hershëm të nevojave dhe lidhjen me strukturat përkatëse.

Njësia për Vlerësimin dhe Referimin e Nevojave (NJVRN)

NJVRN është funksionale dhe përbëhet nga një ekip i përhershëm, që përfshin Punonjës të Mbrojtjes së Fëmijës dhe punonjës social, në përputhje me udhëzimet ligjore në fuqi. Administratorët shoqërorë të njësive administrative janë pjesë përbërëse e kësaj njësie, duke kontribuar drejtpërdrejt në identifikimin, vlerësimin dhe referimin e rasteve që kërkojnë ndërhyrje të koordinuar. NJVRN mbulon të gjithë territorin e bashkisë dhe luan një rol kyç në trajtimin e rasteve që kërkojnë vlerësim të kombinuar dhe ndërhyrje ndërsektoriale.

Planifikimi edhe monitorimi

Sektori i Planifikimit Strategjik dhe Monitorimit është përgjegjës për ndjekjen e performancës së shërbimeve sociale, hartimin e raporteve periodike dhe vlerësimin e rezultateve. Ai koordinon mbikëqyrjen e programeve të mbështetura nga buxheti vendor dhe fondi social. Kapacitetet aktuale janë të kufizuara për të garantuar një cikël të plotë të matjes së cilësisë dhe ndikimit të shërbimeve në baza të rregullta.

Qendrat sociale

Në nivel shërbimesh të drejtpërdrejta, Bashkia Durrës operon me gjithsej shtatë qendra sociale që mbulojnë një pjesë të territorit të 11 njësive administrative. Këto përfshijnë:

1. Qendër Ditore për të Moshuarit,
2. Qendra Komunitare Multifunksionale në Rrashbull
3. Qendra Komunitare Multifunksionale Nishtulla,

4. Qendër me bazë komunitare për fëmijët me aftësi të kufizuara,
5. Qendër për Shërbime të Integruara për Familjen në Sukth,
6. Qendër “Fuqizojmë Komunitetin”,
7. Qendër të Strehimit Emergjent të Sigurt.

Këto qendra ofrojnë shërbime për fëmijët, familjet në nevojë, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara, si dhe për gratë dhe vajzat në rrezik. Ato përfshijnë staf të specializuar si punonjës socialë, edukatorë, psikologë dhe personel teknik. Megjithatë, shpërndarja e tyre mbetet e pabarabartë, pasi pjesa më e madhe e qendrave janë të përqendruara në zonat urbane.

Bashkëpunimi me OJF dhe partnerët lokalë

Një praktikë pozitive që karakterizon shërbimet sociale në Bashkinë Durrës është bashkëpunimi i ngushtë ndërmjet stafit të Drejtorisë së Shërbimeve Sociale dhe stafit të qendrave me organizatat jofitimprurëse, donatorët dhe strukturat me model miks publik-privat. Ky bashkëpunim synon të zgjerojë gamën e shërbimeve dhe të përfshijë ndërhyrje më të specializuara për kategori të ndryshme në nevojë.

Trajnimet e ofruara nga OJF-të dhe partnerët ndërkombëtarë kanë ndihmuar ndjeshëm në rritjen e kapaciteteve të stafit të bashkisë dhe qendrave, duke përmirësuar cilësinë e shërbimeve dhe duke kontribuar në ndërtimin e një qasjeje më të integruar dhe bashkëpunuese në nivel vendor.

Megjithatë, një sfidë e vazhdueshme mbetet pabarazia territoriale në shtrirjen e këtyre shërbimeve. Shumica e shërbimeve dhe partneriteteve janë të përqendruara në zonat urbane, ndërsa njësitë rurale kanë akses të kufizuar në mbështetje të strukturuar dhe profesionale. Kjo ndikon drejtpërdrejt në barazinë e aksesit në shërbime dhe e bën më të vështirë adresimin e nevojave në komunitetet më të largëta.


Menaxhimi i shërbimeve shoqërore në situatë emergjence

Për sa i përket menaxhimit të shërbimeve shoqërore në situatë emergjente, Bashkia Durrës ka hartuar një udhërrëfyes/Protokoll për Ofruesit e Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror në Situata Emergjence. Dokumenti përcakton procedurat standarde të reagimit dhe rolet përkatëse të strukturave të përfshira në menaxhimin e situatave të tilla. Kjo nismë përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt institucionalizimit të përgjigjes së koordinuar. Megjithatë, zbatimi efektiv në praktikë kërkon rritje të kapaciteteve të stafit përmes trajnimeve të rregullta dhe ushtrimeve simuluese.

Të dhënat e paraqitura tregojnë se Bashkia Durrës ka ngritur struktura të rëndësishme për ofrimin e shërbimeve sociale dhe ka zhvilluar partneritete funksionale me aktorë të tretë, duke ndikuar pozitivisht në zgjerimin dhe përmirësimin e mbështetjes për grupet në nevojë. Megjithatë, sfidat mbeten të pranishme, veçanërisht në drejtim të shpërndarjes së barabartë të shërbimeve në të gjithë territorin. Edhe pse NJVRN është funksionale dhe

administratorët shoqërorë janë të pranishëm në çdo njësi administrative, mungesa e shërbimeve të strukturuar – si qendrat sociale, stafi i specializuar dhe mbështetja profesionale e qëndrueshme – në disa njësi rurale kufizon aksesin e popullsisë në ndihmë të rregullt dhe të integruar. Këto boshllëqe kërkojnë ndërhyrje të planifikuara për decentralizimin e shërbimeve, forcimin e burimeve njerëzore dhe logjistike në nivel vendor, si dhe për përcaktimin e prioriteteve në planifikimin social të ardhshëm.

Figura 15 Niveli i përmbushjes së kërkesave ligjore për strukturat dhe pozicionet kyçe në sektorin e shërbimeve sociale – Bashkia Durrës



Burimi: Bashkia Durrës Maj 2024

Figura paraqet një krahasim midis kërkesave ligjore dhe gjendjes aktuale në Bashkinë Durrës në lidhje me pozicionet dhe strukturat kryesore të sektorit të shërbimeve sociale, mbi një shkallë vlerësimi nga 1 (mungesë) në 3 (plotësim i plotë). Bashkia ka përmbushur kërkesat për pozicione si PMF, Koordinatorin për Dhunën në Familje dhe Administratorët Shoqërorë. Megjithatë, dallime vërehen në drejtim të decentralizimit të shërbimeve. Në veçanti, **NJVRN është një strukturë e sapo ngritur**, e cila ndonëse funksionale, ka ende nevojë për **forcim të kapaciteteve dhe mbështetje teknike** për të garantuar një funksionim të qëndrueshëm dhe efektiv në të gjitha njësitë administrative. Këto boshllëqe theksojnë nevojën për përforsim të burimeve njerëzore dhe zhvillim të mëtejshëm organizativ në nivel vendor.

3. Shërbimet e mbuluara dhe kapacitetet reale

Analiza e shërbimeve të mbuluara dhe kapaciteteve reale në Bashkinë Durrës synon të japë një panoramë të qartë mbi shtrirjen territoriale të shërbimeve sociale, përfituesit dhe

burimet ekzistuese, duke evidentuar lidhjen midis vendndodhjes së qendrave sociale, rolit të OJF-ve dhe kapaciteteve vendore për menaxhimin e rasteve. Qëllimi është të identifikohen boshllëqet dhe fushat që kërkojnë ndërhyrje për të siguruar mbulim të barabartë dhe të qëndrueshëm në të gjithë territorin e bashkisë.


Shërbimet sociale ofrohen përmes qendrave komunitare dhe multifunksionale që janë të përqendruara kryesisht në zonat urbane, duke mbuluar kategori të ndryshme në nevojë. Në njësitë rurale si Manëz, Ishëm dhe Katundi i Ri, shërbimet janë më të kufizuara dhe mbështetja ofrohet kryesisht nga administratorët shoqërorë, si dhe nga iniciativat e OJF-ve që mundësojnë shërbime online dhe informim komunitar. Kjo shpërndarje e pabarabartë thekson nevojën për një zgjerim të shërbimeve drejt zonave më të largëta dhe për forcimin e kapaciteteve në nivel vendor.

NJVRN është ngritur në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe përbëhet nga një ekip ndërdisiplinor që përfshin punonjësin e mbrojtjes së fëmijës, punonjësin social dhe administratorët shoqërorë. Megjithëse funksionale, kjo strukturë është ende në fazat e para të zhvillimit dhe ka nevojë për trajnime të mëtejshme dhe mbështetje teknike për të garantuar një menaxhim më efektiv të rasteve komplekse dhe ndërsektoriale.

Në përgjithësi, shërbimet ekzistuese përfaqësojnë një bazë të mirë funksionale, por ato kanë nevojë për **zgjerim territorial, shtim të burimeve njerëzore dhe mbështetje logjistike** për të garantuar akses të barabartë dhe mbulim të plotë në të gjithë Bashkinë Durrës.

Situata aktuale tregon se Bashkia Durrës ka hedhur hapa të rëndësishëm në ndërtimin e një rrjeti shërbimesh sociale, por kapacitetet reale për mbulimin e territorit dhe menaxhimin e rasteve mbeten të pjesshme. Mungesa e strukturave të organizuara në njësi të caktuara administrative, nevoja për trajnime të mëtejshme për NJVRN dhe varësia nga mbështetja e donatorëve në disa shërbime theksojnë rëndësinë e forcimit të burimeve vendore. Rritja e kapaciteteve njerëzore, shtrirja graduale e qendrave të shërbimit në zonat rurale dhe fuqizimi i bashkëpunimit me OJF-të do të jenë vendimtare për të siguruar akses të barabartë dhe gjithëpërfshirës në shërbime për të gjitha kategoritë në nevojë.

Grafiku16: Prania e Shërbimeve Shoqërore në Njësitë Administrative të Bashkisë Durrës



Burimi: Bashkia Durrës 2024

Shënim: Grafiku 16 përmbledh në mënyrë të qartë praninë ose mungesën e shërbimeve të plota, pjesore, online, administratorëve dhe NJVRN në çdo njësi administrative të Bashkisë Durrës. Qyteti Durrës nuk ofron shërbime të plota për të gjitha kategoritë, prandaj është kategorizuar me ✓ vetëm për shërbime pjesore. Ngjyra e gjelbër sinjalizon praninë e shërbimit, ndërsa e bardha tregon mungesën. Shenjat ✓ dhe X ndihmojnë për identifikim të shpejtë të boshllëqeve territoriale.

Grafiku pasqyron në mënyrë vizuale përhapjen dhe tipologjinë e shërbimeve shoqërore në gjashtë njësitë administrative të Bashkisë Durrës, duke evidentuar qartë boshllëqet ekzistuese në mbulimin territorial. Ai tregon se, ndonëse në qytet dhe në disa njësi si Sukthi dhe Rrashbulli janë të pranishme forma të ndryshme shërbimesh (fizike dhe online), mungojnë shërbimet e plota për të gjitha kategoritë në nevojë. Ndërkohë, në njësitë rurale si Manëz, Ishëm dhe Katundi i Ri, mbështetja mbështetet kryesisht në rolin e administratorëve dhe bashkëpunimin me OJF-të. Kjo shpërndarje e pabarabartë thekson nevojën për zgjerim të rrjetit të qendrave sociale, forcim të NJVRN-së dhe përmirësim të aksesit në shërbime të strukturuar në të gjithë territorin e bashkisë.

4. Nevojat për ndërhyrje prioritare

Analiza e kapaciteteve dhe shpërndarjes aktuale të burimeve njerëzore në Bashkinë Durrës evidenton disa boshllëqe kritike që kufizojnë ofrimin e shërbimeve të barabarta dhe të qëndrueshme në të gjithë territorin. Për të garantuar një sistem shërbimesh sociale funksional, gjithëpërfshirës dhe të decentralizuar, kërkohen ndërhyrje të mirëplanifikuara në fushën e burimeve njerëzore, si më poshtë:

- ✓ **Shtimi i punonjësve socialë dhe specialistëve** në njësitë rurale për të siguruar mbulim të barabartë dhe shërbime të aksesueshme për të gjitha kategoritë në nevojë.

- ✓ **Konsolidimi i NJVRN** si një strukturë funksionale dhe ndërsektoriale në çdo njësi administrative, për të mundësuar një qasje të integruar dhe koordinuar në trajtimin e rasteve.
- ✓ **Trajnime të vazhdueshme për të gjithë stafin**, me fokus në menaxhimin e rasteve komplekse, ndërhyrjet ndërinstitucionale dhe reagimin në situata emergjente.
- ✓ **Krijimi i pozicioneve të reja të dedikuara** për kategori që aktualisht nuk mbulohen në mënyrë të strukturuar, si: të moshuarit, të rinjtë në rrezik, përdoruesit e substancave, personat me aftësi të kufizuara mbi moshën 18 vjeç dhe anëtarët e komuniteteve romë dhe egjiptiane.
- ✓ **Riorganizimi i strukturës së Drejtorisë së Shërbimeve Sociale**, për të rritur koherencën ndërmjet sektorëve të saj, për të përmirësuar menaxhimin e brendshëm dhe për të forcuar reagimin institucional në nivel vendor.

Përmbledhje e diagnozës sociale për Burimet Njerëzore

Burimet njerëzore përbëjnë një komponent kyç në funksionimin e shërbimeve sociale në Bashkinë Durrës, e cila ka ngritur një strukturë institucionale me tre sektorë funksionalë dhe NJVRN-në që mbulon të gjithë territorin. Pavarësisht këtij zhvillimi, sfidat mbeten të pranishme, përfshirë mungesën e stafit të mjaftueshëm, mbingarkesën e punonjësve ekzistues dhe shpërndarjen e pabarabartë të burimeve. Zonat rurale mbeten të nënpërfaqësuar në shtrirjen territoriale të qendrave ekzistuese. Struktura aktuale përfiton nga bashkëpunimi me OJF-të, por në disa zona mungojnë qendra sociale dhe mbështetja e organizuar. Këto boshllëqe tregojnë nevojën për rritje të kapaciteteve njerëzore, decentralizim të shërbimeve dhe trajnime të vazhdueshme për të garantuar akses të barabartë dhe shërbime cilësore për të gjitha kategoritë në nevojë.

4. Përmbyllje e diagnozës së Planit Social Vendor në Bashkinë Durrës

Diagnoza e ndërtuar mbi tre komponentët kryesorë: i) kategoritë në nevojë; ii) shërbimet shoqërore dhe iii) burimet njerëzore, evidenton boshllëqet ekzistuese, pabarazitë territoriale dhe sfidat në kapacitete që kufizojnë funksionimin e sistemit të mbrojtjes sociale në Bashkinë Durrës. Nga analiza dalin tre drejtime prioritare për ndërhyrje:

1. **Forcimi i kapaciteteve dhe eficiencës së shërbimeve sociale**, përmes ristrukturimit të brendshëm, shtimit të stafit dhe ndarjes së qartë të funksioneve.
2. **Zgjerimi dhe diversifikimi i shërbimeve për grupet në nevojë**, duke përfshirë zonat rurale, kategori të pambuluara dhe situatat emergjente.
3. **Rritja e aksesit dhe informimit të qytetarëve**, veçanërisht për grupet më të përjashtuara, përmes ndërmjetësimit komunitar dhe fushatave ndërgjegjëse.

Këto drejtime përbëjnë bazën për ndërtimin e një sistemi social gjithëpërfshirës, të decentralizuar dhe të orientuar nga të drejtat, ku askush nuk mbetet pas.

5. Analiza SËOT

Analiza SËOT më poshtë sintetizon pikat e forta, dobësitë, mundësitë dhe kërcënimet e identifikuar gjatë diagnozës, duke orientuar vendimmarrjen strategjike në hartimin e Planit Social Vendor.

Grafiku 17: Analiza Sëot



Diagnoza e përgatitur përfaqëson një bazë të strukturuar dhe gjithëpërfshirëse për hartimin e Planit Social Vendor të Bashkisë Durrës.

Ajo siguron një pasqyrë të qartë mbi nevojat prioritare të grupeve vulnerabël, kapacitetet ekzistuese institucionale dhe boshllëqet në ofrimin e shërbimeve sociale, duke orientuar procesin e vendimmarrjes strategjike në nivel vendor.

Në mbështetje të këtij qëllimi, analiza SËOT dhe tabela përmbledhëse me prioritetet sipas tre shtyllave ofrojnë një strukturim të qartë të sfidave, burimeve dhe mundësive për ndërhyrje, duke lehtësuar përkthimin e diagnozës në veprim konkret.

Gjetjet e diagnozës do të shërbejnë si bazë për formulimin e objektivave strategjike, masave ndërhyrëse dhe treguesve të matshëm në Planin Social Vendor 2025–2028.

Përmes këtij angazhimi, Bashkia Durrës synon të ndërtojë një sistem më të drejtë, të barabartë dhe të qëndrueshëm shërbimesh për të gjithë qytetarët, pa përjashtim.

IV. Vizioni, Misioni , Prioritetet Strategjike dhe Objektivat(2–3 faqe)

Hartimi i këtij Plani Vendor të Mbrojtjes Sociale për Bashkinë Durrës është ndërtuar mbi një diagnozë të detajuar të nevojave sociale në territor, duke evidentuar qartë sfidat në mbështetjen e grupeve vulnerabël, shpërndarjen e shërbimeve dhe kapacitetet institucionale ekzistuese. Ky proces analize përbën themelin për përcaktimin e prioriteteve dhe objektivave strategjike të planit.

Në përputhje me **Strategjinë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2023–2030**, e cila synon ndërtimin e një sistemi social gjithëpërfshirës, reagues dhe të qëndrueshëm, Plani Social Vendor fokusohet në ndërhyrje që garantojnë barazi në akses, forcim të kapaciteteve lokale dhe përfshirje të qytetarëve në proceset sociale.

Tre prioritetet kryesore të Planit – forcimi i kapaciteteve dhe eficiencës së shërbimeve sociale; konsolidimi dhe zgjerimi i shërbimeve për grupet në nevojë; si dhe rritja e ndërgjegjësimit dhe përfshirjes sociale – janë të ndërlidhura ngushtë me parimet e Strategjisë Kombëtare dhe përbëjnë mekanizma konkretë për zbatimin e saj në nivel lokal.

Vizioni

Një shoqëri gjithëpërfshirëse në Bashkinë Durrës, që fuqizon dhe mbështet çdo individ në nevojë për të jetuar një jetë dinjitoze, aktive dhe të pavarur.

Misioni

